

**Trepça Shoqëri Aksionare**  
**Trepça Joint Stock Companies**  
**Trepça Deoničarsko Društvo**

Nr. 496 Data. 30.01.2023  
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada-Government*

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



**RREGULLORE PËR REPREZENTACION NË TREPÇA SHA.**



Mitrovicë, më 26.01.2023

Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 8 të Statutit të Trepça Sh.A, Bordi i Mbikëqyrës i Trepça Sh.A., në mbledhjen e mbajtur më 26.01.2023, miraton këtë:

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë shumën maksimale të reprezentacionit në Ndërmarrjen Trepça SH.A.si dhe procedurën e përdorimit të rregullt gjatë kryerjes së punëve dhe ushtrimit të përgjegjësisë nga të punësuarit e ndërmarrjes.

## **Neni 2**

### **Reprezentacioni**

1. Të drejtën në reprezentacion e kanë:

- 1.1. Kryeshefi Ekzekutiv.
- 1.2. Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv.
- 1.3. Sekretari Korporativ.
- 1.4. Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit dhe
- 1.5. Zyrtari i Auditimit të Brendshëm.
- 1.6. Udhëheqësit e Njësive Biznesore.

2. Me vendim të veçantë të Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A mund të përcaktohen kufizime në vlera lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të reprezentacionit.

## **Neni 3**

### **Vlera e shpenzimeve të reprezentacionit**

1. Në emër të reprezentacionit jashtë ndërmarrjes Kryeshefi Ekzekutiv ka të drejtën e shpenzimeve për dreka zyrtare deri në 12,000 euro (dymbëdhjetë mijë ) në vit, ndërsa zyrtarët e lartë Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv, Sekretari Korporativ, Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit dhe Zyrtari i Auditimit të Brendshëm kanë të drejtën secili nga 1,200 euro (njëmijë e dyqind) dhe dy Udhëheqësit e Njësive Biznesore Stantërg dhe Kishnicë nga 1,200 euro (njëmijë e dyqind) në vit.



2. Në emër të përfaqësimit (reprezentacionit) nga bufeja e ndërmarrjes Trepça SH.A. menaxhmenti i ndërmarrjes ka të drejtë të shpenzimit deri në 500 euro në muaj.

3. Në emër të përfaqësimit të ndërmarrjes me rastin e festës së Vitit të Ri (kalendar, notesa, lapsa ) menaxhmenti i ndërmarrjes ka të drejtë të shpenzimeve të përbashkëta deri 10.000 euro (dhjetë mijë) në vit.

#### Neni 4

##### Përdorimi i shpenzimeve të reprezentacionit

1. Shpenzimet e reprezentacionit nuk mund të përdoren për qëllime të tjera përveç atyre që janë të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Të gjitha shpenzimet e reprezentacionit duhet të arsyetohen me fatura përkatëse të nënshkuara nga shpenzuesi i reprezentacionit, i autorizuar i kësaj rregullore.

3. Faturat përkatëse të cilat nuk janë të nënshkuara nga shpenzuesi i autorizuar sipas kësaj rregulloreje nuk do të pranohen dhe do të mbulohen nga vetë zyrtari (shfrytëzuesi) në mënyrë individuale.

#### Neni 5

##### Fusha e zbatimit


1. Rregullorja bazike Nr.876 e datës 23.02.2022 për Reprerentacion në Trepça SH.A shfuqizohet me hyrjen në fuqi të rregullores së re për Reprerentacion në Trepça Sh.A.

#### Neni 6

##### Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore për Reprerentacion në Trepça Sh.A, hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe fillon të aplikohet prej ditës së publikimit në webfaqen zyrtare.

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A

  
Dr.Sc. Bahri Hyseni

